

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Fillimi i procedurave për dhënie me qira me anë të konkurimit të sipërfaqes së fondit Pyjor/kullosor publik sipas udhëzimit nr.1, date 09.06.2016” Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave Për Dhënie Në Përdorim të Fondit Pyjor Dhe Kullosor Publik”, që i përket ekonomisë Pyjore Drin Gjadër Kirë, ngastrat Nr. 4, në sipërfaqe prej 35 ha dhe ngastrat Nr. 10 në sipërfaqe prej 5.3, ha, Gjithsejt 40.3 ha “për park fotovoltaike, me afat përdorimi (qiraje), 9 (nëntë) vite.

2. Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit është 143,000 leke/ha/vit dhe për 40.3 ha është 5,762,900 lekë në vit në sipërfaqe djerre, e përlloritur kjo sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

3. Qëllimi i përdorimit është dhënia në gëzim të përkohshëm të sipërfaqes pyjore “për park fotovoltaike”.

5. Pikët vlerësuese sipas kriterëve të konkurimit për subjektet që konkurojnë do të jenë :

Nr .	Lloji i Kriterit	Pesha e matur në pike e kriterit vlerësues (e shprehur në pikë)
1	Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit	20
2	planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15
3	planin e rehabilitimit të sipërfaqes	15
4	nivelin e punësimit në veprimtari	5
5	masën e qirasë për lek/ha/vit	35

6. Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për konkurrim është:

Personat fizik dhe juridik që marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e) të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- g) nivelin e punësimit në veprimtari;

- h) lejen mjedisore per aktivitetin e kërkuar/vleresim i ndikimit ne mjedis paraprak(VNM)
 i) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
 j) adresën e subjektit, telefon, email, dhe faks.

7. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurim janë:

- a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
 b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
 c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim ne proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

8. Vendi i zhvillimit të konkurimit: (Adresa:) Zyra Drejtorise Pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes se Mjedisit, Bashkia Vau Dejës.

9. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: me date 23.09.2022, ora 12.00

10. Informacion mbi dokumentet e ankandit/konkurimit:

Dokumentet e ankandit/konkurimit mund te trerhiqen prane autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

Po	X	Jo	<input type="checkbox"/>
Nëse Po	Monedha	leke	Çmimi
			1500

Dokumentet standarde te ankandit/konkurimit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

11. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e konkurimit .

BASHKIA POGRADEÇ

NJOFTIM I KONTRATËS TË NËNSHKRUAR PËR MARRJEN ME QIRA

1. Autoriteti i marrjes me qera